



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike  
Mbledhja nr. 08  
Prishtinë, më 9 mars 2010, në orën 10: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**I Mbledhjes së Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Arsim Rexhepi, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Anita Morina-Saraçi.

Munguan: Gani Koci dhe Enis Kervan.

**Nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik:** Nexhat Shabani dhe Ramadan Gashi – anëtarë të bordit të KRPP-së.

**Të pranishëm:** Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, nga KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari, Qemajl Marmullakaj dhe Albert Krasniqi, nga zyra e Presidentit - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi z.Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky  
Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16. 02. 2010,**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik mbi aktivitetin e prokurimit publik ne Kosovë për vitin 2009;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se ish-in plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.02. 2010**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16 shkurt 2010, pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i raportit të KRPP-se mbi aktivitetin e prokurimit publik ne Kosovë për vitin 2009;**

**Kryesuesi**– Tha se KRPP me kohë ka paraqitur në Kuvend raportin vjetor për vitin 2009. Komisioni për Mbikëqyrjen e financave publike është komision funksional për shqyrtimin e këtij raporti dhe komision që i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës më tutje për procedurë. Për të prezantuar këtë raport kemi ftuar përfaqësues të KRPP-së. Propozoi që fillimisht të prezantohet raporti nga përfaqësuesit e KRPP-së, pastaj të hapet debati.

**Nexhat Shabani** – përfaqësues nga KRPP – Ky raport është përpiluar duke i përmbledhur të dhënat e të gjitha autoriteteve kontraktuese të Kosovës, të cilat i kanë dërguar për aktivitetet e tyre gjatë vitit 2009. Gjatë vitit 2008, KRPP ka pasur 142 autoritete kontraktuese aktive. Gjatë vitit 2009 është rrit numri i aktiviteve kontraktuese aktive, kështu që ne i kemi të regjistruara 152 autoritete kontraktuese aktive. Nga ky numër, tre nga autoritetet kontraktuese nuk u janë përgjigjur obligimit për t'i dërguar raportet, e këto janë: Komuna e Zveqanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Kjo në shifra paraqet 0.3% të vlerës së buxhetit të shpenzuar përmes procedurave të prokurimit ose më saktë vlera e shpenzuar përmes procedurave të prokurimit në këto tri komuna është gjithsejtë 2.334.220 euro, domethënë nuk na janë paraqitur të dhëna për mënyrën e procedimit të këtyre prokurimeve nga këto tri komuna. Gjatë vitit 2009 janë realizuar dhe nënshkruar gjithsej 14.820 kontrata publike, që në krahasim me vitin 2008 është në rritje për 3.5%. Ne kemi paraqitur të dhënat statistikore në bazë të një tablele që ne i kemi obliguar operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese që të na dërgojnë. I kemi ndarë kontratat që janë të nënshkruara dhe të publikuara nga qeveria, kompanitë publike dhe të tjera. Nga këto kontrata 67%, janë kontrata nga institucionet qeveritare. Pastaj, kemi tabelat që kemi përshkruar-kombinuar për vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009, ku vlera e përgjithshme është 778.153.515 euro. Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara përmes procedurave të prokurimit në krahasim me vitin 2008 - vlera prej 5.85% është më e vogël. Ne kemi nxjerr të dhënat edhe për burimet financiare të shpenzuara për kontratat e nënshkruara. Këtu kemi bërë ndarjen: burimet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, të hyra vetanake dhe donacione. Shihet se vlera më e madhe është nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, që domethënë 586.539.985 euro nga Buxheti i Kosovës janë shpenzuar për prokurime. Ne kemi bërë ndarjen dhe krahasimin edhe të kontratave sipas llojit të prokurimit, ku kemi: kontrata për furnizime, kontrata për shërbime, konkurs projektimet dhe për punë. Vlera më e madhe e shpenzuar përmes procedurave të prokurimit është për llojin e kontratave pune. Shihet se mbi 424.000.000 euro janë kontraktuar për kontrata pune. Pastaj vijë furnizimet me 289.000.000 euro etj Kemi bërë ndarjen e kontratave sipas vlerës, dhe meqenëse se Ligji i prokurimit i ndan vlerat: në vlera të mëdha, të mesme, të vogla dhe minimale edhe ne i kemi bërë këto ndarje. Nga këto të dhëna kemi nxjerr se - vlera më e madhe e kontratave të nënshkruara është me vlerat e mëdha të kontratave, që domethënë 575.602.784 euro, pastaj vijë kontratat me vlerë të mesme, e kështu me radhë, sipas radhitjes është edhe vlera.

Një ndarje tjetër që kemi bërë është: vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009, sipas procedurave të prokurimit që janë përdorur gjatë aktiviteve të prokurimit. Ligji i prokurimit i njeh 7 procedura të prokurimit, por jep edhe udhëzimet se në cilat raste mund të përdoren këto procedura. Procedura më transparente dhe më e preferuar është procedura e hapur. Kontratat janë nënshkruar në vlerë prej 660 milionë euro dhe procedurat e kufizuara nuk janë përdorur fare, as në vitin 2008, as në vitin 2009, kurse në vitin 2007 janë përdorur këto procedura. Kemi pas edhe procedurat edhe për konkurs projektimi, procedurat e negociuara, janë përdorur dhe në krahasim me procedurat e hapura rreth 46% të prokurimeve janë përdorur këto procedura. Në krahasim me vitin e kaluar vërehet një ulje në vlerë, mirëpo kjo ulje vjen ngase në vitin e kaluar kanë qenë dy kontrata të Korporatës Energjetike të Kosovës në vlerë mbi 70 milionë euro, të cilat kanë qenë afatgjata që e kanë arrit vlerën dhe që janë proceduar përmes procedurës së negociuar. Kjo procedurë është më pak transparente, sepse bëhet vetëm me një operator pa konkurrencë. Gjatë vitit 2008 kemi pasur 164 milionë kontrata të nënshkruara me procedurë të negociuar, ndërsa këtë vit kemi 87 milionë. Nga të dhënat që kemi marr nga autoritetet kontraktuese, kemi kërkuar

tabelën që të na paraqitet vlera e planifikuar e prokurimit dhe vlera e nënshkuar e kontratës. Duke bërë këto krahasime kemi nxjerr se vlera e gjithmbarshme ka qenë e planifikuar për 804 milionë euro, kurse është realizuar me 778 milionë. Këtu nga të dhënat na paraqitet një kursim prej afër 26 milionë. Këto të dhëna i kemi krahasuar nga tabelat, nga të dhënat që na janë dërguar. Ne nuk i konsiderojmë shumë të sakta këto të dhëna, sepse në shumicën e rasteve autoritetet nuk na e kanë dhënë vlerën e parallogaritur, por vetëm na i kanë dërguar vlerat e kontraktuara. Këtë vit, kemi kërkuar të na paraqiten nga autoritetet kontratat e nënshkuara dhe anekskontratat. Anekskontratat, kryesisht bëhen prej procedurave të negociuara. Vlera e anekskontratave është 8.837.000euro. Kemi gjithsej 265 anekskontrata që përbën 1.08% të vlerës së kontratave të nënshkuara.

Kemi bërë edhe një regjistrim tabelor, për vlerën e kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2009, sipas operatorëve ekonomik vendor dhe jovendor. Nga 14.820 kontrata të nënshkuara, janë 206 kontrata të nënshkuara me operator jo vendor, do të thotë jashtë Kosovës, kurse pjesa tjetër 14.616 janë kontrata të nënshkuara nga kompani-operator vendor. Në vlerë është 112.800.000 vlera e kontratave të nënshkuara me operatorët jovendor, ndërsa vlera tjetër me operator vendor. Kemi bërë paraqitjen edhe të vlerës së kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2009, sipas afatit kohor të publikuar. Ligji përcakton varësisht nga vlera e kontratës, edhe afatet kohore për publikim, për njoftim të kontratave, për vlera të kontratave, sa është afati më i gjatë, mirëpo ligji parasheh edhe mundësinë e përshpejtimt të afatit të publikimit me një arsyetim kur është e nevojshme dhe kur e lejon ligji, të cilin afat operatorët mund ta përdorin pa marrë autorizime nga organet qendrore, por nga zyrtari i lartë- autorizues nga autoritetet ku merret leja. Afatet normale kohore janë përdorur në 60% të rasteve të kontratave të nënshkuara, kurse në vlerë mbi 587 milionë. Kurse, afate të përshpejtuara 39,95% të kontratave të nënshkuara ose mbi 190 milionë euro në vlerë.

Kemi paraqitur në formë tabelore edhe vlerën e kontratave të nënshkuara sipas kriterit për dhënie të kontratës. Ligji i prokurimit i njih vetëm dy kritere për përzgjedhjen e operatorëve ekonomik për nënshkrim të kontratës. Është kriteri: *çmimi më i ultë dhe çmimi ekonomikisht më i favorshëm*. Në të gjitha rastet përdoret çmimi më i ultë, kurse në disa raste mund të përdoret çmimi ekonomikisht më i favorshëm, kur autoriteti ka ndonjë favor tjetër përveç çmimit. Mirëpo, ligji cakton saktësisht mënyrën e përcaktimit të kritereve rreth përzgjedhjes. Në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2009 në mbi 56% të kontratave të nënshkuara, është përdorur kriteri çmimi më i ultë. Ky kriter është kriteri më i favorshëm për autoritetet kontraktuese apo për Buxhetin e Kosovës në vlerë prej 420 milionë euro, kurse kriteri ekonomikisht më i favorshëm është përdorur 43.7% të kontratave të nënshkuara në vlerë prej 357 milionë euro. Në tabelë kemi paraqitur edhe të gjitha autoritetet kontraktuese, do të thotë 148 autoritete kontraktuese për numrin e kontratave që kanë realizuar gjatë vitit 2009 dhe vlerën e kontratave ose në pjesëmarrje me përqindje në vlerën e përgjithshme të prokurimit, në formën e alfabetit. Kemi nxjerr të dhëna edhe nga të dhënat edhe autoritetet kontraktuese me vlerë të përgjithshme të kontratave të nënshkuara që tejkalojnë vlerën 4 milionë euro. Numri i kontratave më të mëdha që e tejkalojnë vlerën 4 milionëshe ka realizuar KEK-u më së shumti, gjithsej mbi 170 milionë euro ose në përqindje 34.94% më pak se në vitin e kaluar. Në vendin e dytë për nga numri i kontratave dhe vlerës së kontratave të nënshkuara është Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit e cila ka nënshkuar kontrata me vlerë mbi vlerën 4 milionë, në vlerë 153milionë dhe i treti vjen Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në vlerë mbi 66 milionë euro, etj. Ne kemi dhënë edhe kontratat me emër dhe numrin e kontratave që e tejkalojnë vlerën 4milionë dhe 3milionë euro. Më tutje kemi dhënë aktivitetet e tjera të komisionit rregullativ, gjatë vitit 2009.

**Ramadan Gashi** – KRPP, është i përbërë prej 4 departamenteve: departamenti i rregullave, departamenti i mbikëqyrjes dhe monitorimit, departamenti i trajnimeve dhe departamenti i teknologjisë informative. Departamenti i rregullave gjatë vitit 2009 ka bërë harmonizimin e të gjitha akteve nënligjore të cilat kanë qenë të parapara të harmonizohen me ndryshimin e ligjit që është bërë në vitin 2007. Gjatë vitit 2008 është bërë edhe harmonizimi i ligjit sa i përket çështjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme, respektivisht për përfaqësitë diplomatike dhe konsulare,

sepse në realizimin e aktiviteteve të prokurimit Ministria e punëve të jashtme ka hasur në pengesa me dispozitat e ligjit ekzistues. Këto ndryshime të ligjit janë aprovuar në Kuvend në muajin qershor të vitit 2009 dhe brenda 1 muaji Komisioni Rregullativ ka bërë harmonizimin e të gjitha akteve nënligjore lidhur me këtë ndryshim të ligjit. Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim ka për detyrë që të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të aktiviteteve të prokurimit të të gjitha autoriteteve kontraktuese në Kosovë të cilat u përmendën se janë 152 në këtë vit. Gjatë vitit 2009, Departamenti i mbikëqyrjes dhe monitorimit ka realizuar rreth 52 mbikëqyrje dhe monitorime sipas planit dhe një numër të monitorimit dhe mbikëqyrje sipas kërkesave dhe nevojave të parashtruara qoftë nga ndonjë autoritet kontraktues, nga ndonjë operator ekonomik apo nga vetë Komisioni Rregullativ i prokurimit publik. Që të arrihet të bëhet një mbikëqyrje e të gjitha aktiviteteve kontraktuese në Kosovë ka munguar numri i të punësuarve në këtë departament. Momentalisht janë shtatë të punësuar në këtë departament. Vetëm gjatë vitit 2008-2009, nëntë punëtorë të Komisionit Rregullativ të prokurimit publik e kanë lëshuar vendin e punës dhe kanë shkuar në institucione të tjera ku realizojnë paga shumë më të mëdha. Prandaj, ju propozoj ju dhe Komisionit për buxhet dhe financa që të na mundësojnë që disi t'ia bëjmë një zgjedhje në rritjen e pagave të këtyre ekspertëve, sepse këta janë të vetmit ekspert të prokurimit të cilët gjinden në këtë institucion. Departamenti i teknologjisë informative është një departament i cili punon rregullisht në shpalljen e njoftimeve për kontratë, statistika, shpalljen e anulimeve, i cili është përgjegjës për përcjelljen dhe mbikëqyrjen e web-faqes e KRPP-se, e cila, ne vlerësojmë se është një web-faqe shumë e mirë. Të gjitha të dhënat të cilat KRPP-ja nëpër departamente i realizon gjatë vitit bëhen publike në këtë web faqe, dhe janë publike për çdo person i cili është i interesuar që t'i shoh ato.

Trajnimet kanë shkuar mirë, ndoshta me një vonesë është filluar, por megjithatë janë realizuar në afatin e paraparë. Janë mbajtur testimet janë certifikuar një numër i zyrtarëve, e që në krahasim me vitin tjetër është një numër pak më i vogël. 224 zyrtarë të prokurimit janë certifikuar në vitin 2009, ndërsa në vitin 2008 -431. Pesë vite që ne jemi si komision që mbikëqyrim realizimin e Ligjit mbi prokurimin publik në Kosovë, numri i të trajnuarve dhe të certifikuarve është rritur, në përjashtim me vitin 2009 ku është një zvogëlim. Kjo nuk është një dobësi e dikujt, trajnimet i kanë përcjell një numër i madh, por në momentin kur është organizuar testimi nuk kanë hyrë ose nuk janë paraqitur për arsye të ndryshme, një numër nuk e kanë kaluar me sukses dhe kështu kanë mbetur pa u certifikuar.

**Riza Smaka** – Tha se prokurimi është një çështje mjaftë aktuale, akute, tepër e përfolur. Pyeti: a konsideroni edhe ju se ka abuzime të mëdha dhe ka spekulime të mëdha, ndër të tjera si pasojë e Ligjit për prokurimin publik? Sepse edhe ju e keni theksuar se ky ligj duhet të ndryshohet dhe të plotësohet, si pasojë e paqartësisë, nuk i rregullon çështjet sa dhe si duhet, ka kontradikta që paraqiten probleme tepër të rënda në jetën shoqërore, ekonomike e politike. Ndoshta nuk do të duhej të thuhej “*të shikohej mundësia e përmirësimit*”, por të ndërmerret një nismë menjëherë, sepse më të thirrurit jeni ju, më kompetentët jeni ju.

Çfarë është kualiteti i kontratave në aplikimin e prokurimit publik? A janë këto kontrata çfarë do të duhej të ishin? A kanë instrumente juridike për përforcimin e tyre si advansin, pagën për tërheqje, penale? Kjo është shumë me rendësi sepse ka shumë vonesa. Janë 265 anekskontrata që përbën 1.08% të vlerës së kontratave të nënshkruara. A thua këto për shkak se kontratat nuk bëhen si duhet në fillim me qëllim ose nga injoranca? Ky nuk është vetëm një konstatim formal, por ka sekuenca shoqërore edhe financiare, sepse pikërisht me këto anekskontrata bëhen abuzimet e mëdha, kalohen limitet fillestare të cilat caktohen që më parë. Sa i përket stafit që ju braktisë, duhet të praktikohet që në kontratë të punës të parashihet që zyrtari i cili trajnohet, nëse e lëshon punën para afatit, atëherë ai është i obliguar që të kthej të hollat që janë paguar për aftësimin e tij. Kjo praktikohet nëpër institucione serioze. 5500euro paguajmë qira mujore, kjo është diçka që Qeveria nuk po ndjen kurrfarë përgjegjësie. Pikëpyetje është, a janë objekte formale apo informale. Për Zyre të Auditorit paguhet 14000euro qira. Këto janë para publike, ne e dimë se kush i paguan ato euro, si bëhet ai buxhet e më pastaj shpenzohet në mënyrë më të papërgjegjshme, më injorante. Sa premtimet janë dhënë në fushatë për qiratë etj., përkundrazi tash është rrit kuota. Pra paratë nga buxheti, po e favorizojnë ilegalitetin.

**Safete Hadergjonaj-** Raporti i KRPP-së është proceduar me kohë siç është paraparë me ligj. Çështjet që i parasheh ligji për prokurim publik në përgjithësi janë përfshirë. Sipas raportit ka ardhur duke u rritur tendenca e procedurave të hapura të prokurimit, kurse përfaqësuesit e KRPP-së thanë se procedurat e negociuara janë zvogëluar për 64.84%, duke mos e paraqitur këtë si rezultat, si sukses. Nga raporti shohim se pjesa më e madhe e kontratave të nënshkruara në formën e negociuar është pikërisht nga KEK-u, kurse Aeroporti dhe Ministria e Arsimit, janë dy institucione që kanë nga një kontratë të negociuar. Pse ka shkuar te çështja e negociimit të kontratave, ne këtu nuk mund të japim ndonjë vlerësim, pasi që nuk disponojmë me të dhëna të detajizuara. Kjo është një çështje me të cilën ndoshta duhet të merret auditori, në mënyrë që ne të kemi një konstatim se sa është e arsyeshme një kontratë e tillë. Ne nuk kemi përvojë aq të mirë me formën e negociuar të kontratave nga ana e KEK-ut edhe pse tani shohim se ka shkuar duke rënë kjo forme. Sipas përfaqësuesve të KRPP-së vlera e paraqitur në tabelën ku janë paraqitur kontratat e nënshkruara sipas vlerës së përlogaritur dhe vlerës së Kontratës së nënshkruar gjatë vitit 2009, nuk janë të sakta, sepse nuk kanë marrë të dhënat e përlogaritura. A nuk keni pas mundësi që ju t'i merrni këto të dhëna të duhura apo nuk keni pas mundësi që t'i verifikoni shifrat të cilat i keni marrë nga autoritetet kontraktuese? Ne kemi një raport të cilin duhet ta miratojmë dhe ta procedojmë në kuvend dhe për këtë është mirë që të dhënat e paraqitura të jenë të verifikuara dhe të pasqyrojnë një realitet. Në vitet e mëparshme, por edhe kohën e fundit ka shumë anekskontrata. A ka ndonjë rast që kryhet ndonjë punë pa u shtuar anekskontrata?

Vlera e kontratës së nënshkruar sipas afatit kohor - te rasti i shkurtimeve të afateve dhe zgjatja e afateve, shohim që ka pas shkurtime të afatit, por nuk mund të japim vlerësim nga ky raport. Kjo mbetet që auditori gjatë hulumtimeve të verifikoi se sa ka qenë arsyeshmëria e shkurtimeve të afateve edhe pse çështjet e afateve të përpara me Ligjin e prokurimit publik janë të diskutueshme. Çmimi më i ulët dhe çmimi ekonomikisht më i favorshëm janë çështje të cilat janë debatuar dhe diskutuar shumë, edhe kjo ndoshta i mbetet auditorit të shohë arsyeshmërinë e kësaj çështjeje, ku ka pas shkelje. Nga raporti shohim që janë 152 autoritete kontraktuese. Në mungesë të stafit të mjaftueshëm për mbikëqyrje KRPP nuk ka arrit që të bëjë një mbikëqyrje të të gjitha aktiviteteve kontraktuese në Kosovë. Konsideroi që kjo punë është shumë e rëndësishme dhe fokusimi kryesor i KRPP-së duhet të jetë këtu, e jo vetëm në mbledhjen e shënimeve teknike që i paraqitni në raport. Sa keni paraparë me plan që të bëni monitorime dhe sa prej tyre i keni realizuar? Kjo nuk është paraqitur në raport me përqindje. Janë 43 monitorime sipas planit dhe 9 sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese. Çka ka bërë KRPP në këtë drejtim, përkundër vështirësive me numrin e pakët të stafit, në mënyrë që ky sektorë të jetë më efektiv? Sipas raportit, ka pas shumë trajnime të zyrtarëve të prokurimit dhe shihet se nga 448 zyrtarët të cilët kanë vijuar këto trajnime, 424 kanë kaluar testin. Çka ka ndodhë me ata të cilët nuk kanë kaluar testin?

KRPP ka rekomanduar reformimin e sistemit të prokurimit në Kosovë. Çka e shihni si të domosdoshme që të përfshihet në këtë reformë të prokurimit publik? Çka do të ndikonte në këtë reformë përpos ndryshimit të ligjit?

Rekomandimi i dytë me të cilin keni paraparë që me ligj të rregullohet aktiviteti i prokurimit në sektorin e kompanive publike, është rekomandim shumë i mirë, sepse është çështje ku ka pas abuzime nga më të ndryshmet. Kërkoj shpjegim lidhur me rekomandimin e tretë – çka keni dashur të arrini me këtë që së pari të shkoi kërkesa në ZKA e mandej në OSHP? Ku është efekti i kësaj? Shpresoj që prokurimin elektronik ta fusni në përdorim apo do të jeni përgjegjës për ta bërë. Çka keni bërë ju që të rritet mundësia e qasjes në prokurimin publik për të gjitha palët e interesuara dhe nëse KRPP nuk ka pas mundësi ta bëjë këtë, kush është përgjegjës për ta bërë këtë? Sfidë keni paraparë presionin që ju bëhet zyrtarëve të prokurimit. Si e keni konstatuar këtë presion dhe a keni fakte për këtë çështje?

**Synavere Rysha** – Raporti i KRPP-së është raport i përmbledhur mirë, koncizë dhe mjaftë mirë i ka detajuar çështjet. Shikuar në përgjithësi është një raport i drejtë që pasqyron në një mënyrë punën jo të mirë të organeve të cilat merren me çështje të prokurimit në Kosovë. Zyrtarët të cilët merren me këtë çështje në çfarë mase po arrijnë ta kuptojnë Ligjin e prokurimit në Kosovë? Në vitin 2009 kemi zvogëlim të prokurimeve dhe atë në 5.85%. Kjo është shqetësuese për të gjithë

ne, sepse ne duhet të avancojmë sa i përket çështjeve të prokurimit. Vlera minimale është një pjesë e prokurimeve e cila e kap një shifër mjaftë të madhe, shprehur në përqindje është 9.89%. A është e lartë kjo vlerë 8.9%, krahasuar me të gjitha prokurimet që ndodhin në Kosovë? A ka ndërmarrë diçka KRPP-ja? A i ka sugjeruar autoriteteve apo institucioneve që më së shumti janë marrë me këto çështje? Çfarë kanë qenë veprimet e KRPP-së duke e pasur parasysh se këtu kemi të bëjmë me prokurime njëburimore të cilat ligji më së paku i lejon. Cili ka qenë veprimi i juaj konkret duke e pasur parasysh që jeni të thirrur për rregullimin e kësaj çështje? Nëse i keni identifikuar - a ju keni adresuar ndonjëherë ministrisë, kryeministrit apo edhe zyrtarëve nëpër komuna për këto çështje? Rreth 87 milion e 263 mijë euro të harxhohen me procedura njëburimore është për çdo kritikë? Anekskontratat janë mundësia më e mirë për keqpërdorime. Ligji e lejon anekskontratën dhe ata me çdo kusht e përdorin atë. Çështje tjetër janë anulimi i prokurimeve – rreth 32% prej tyre anulohen. Pse ndodhë kjo? Mos është arsye që autoritetet janë të ngutshme për shpallje të ofertave, duke mos i marrë për bazë kriteret, e pastaj Organi Shqyrtues e pengon. Për mua është e arsyeshme anulimi deri në 5%, por jo deri në 32%. 8% arsye e anulimit është për arsye objektive. Arsyet objektive nuk duhet ekzistojnë fare. *“Një urdhër i lëshuar nga autoriteti kompetent kërkon anulim”*. Cili është ai organ kompetent i cili kërkon anulim? Mos vije këtu në shprehje presioni ndaj zyrtarëve të lartë? Sa i përket sfidave – a nuk është shqetësuese për neve si Kosovë që sfidë kryesore të jetë presioni ndaj zyrtarëve gjatë nënshkrimit të kontratave? Ka disbalancë në mes të prokurimeve të publikuara dhe atyre të anuluar.

**Arsim Rexhepi** – Pyeti: në raport me legjislacionin e kaluar a ka një përparim cilësorë në këtë fushë? Te kapitulli 2.6, çështja e procedurave të kufizuara dhe të negociuara, në bazë të shifrave që na janë ofruar në raport me legjislacionin e kaluar ka një rritje të trefishtë në atë fushë që ju potencuat se mundësitë e paqartësive janë shumë më të mëdha, domethënë te procedura e negociuar që ishte me pak transparente, ndërsa në këtë legjislacion kemi një rënie totale të menjëhershme të procedurave të kufizuara. Pse ndodhë kjo?

**Kosara Nikoliq** – Kërkoj shpjegim nga përfaqësuesit e KRPP-së se nëse thuhet se 152 autoritete kontraktuese, prej të cilave 148 kanë raportuar ndërsa tre nga autoritetet si komuna e Leposaviqit, Zveqanit dhe Zubin Potokut nuk i janë përgjigjur obligimit për t'i dërguar raportet, KRPP ka përgatitë raport e të cilin e prezanton para këtij komisioni dhe nuk ka evidenca për shpenzimet e 2 milion e 334 mijë e 220 euro. Këtij komisioni i intereson shpenzimi i parasë publike. Në raport thuhet *“vetëm”* tri komuna nuk i kanë dorëzuar raportet vjetore. Buxheti i paraparë për këto tri komuna është 2 milion e 334 mijë e 220 euro që marrin pjesë *“vetëm”* me 0.30% në vlerën e gjithmbarshme të kontratave të nënshkruara publike për vitin 2009. Kjo është shumë e madhe, ndërsa në raport figuron që kjo shumë përfshinë *“vetëm”* 0.30% në vlerën e gjithmbarshme. Ne luftojmë për çdo euro se si shpenzohet, si fitohet etj.

**Kryesuesi** – Tha, sipas diskutimeve mund të përfundojmë se raporti i KRPP-së është i pranueshëm. Ky raport përmban elementet që kërkohen në bazë të ligjit dhe është standard që vlerësohet pozitivisht nga ana e komisionit. Raporti prezanton materien në mënyrë reale dhe puna e KRPP-së që është paraparë me ligj në bazë të këtij raporti është përmbushur. Vlerësimet përkatësisht dilemat e të gjithë anëtarëve të komisionit përafërsisht janë të njëjta. Rekomandimet e KRPP-së janë të bazuara dhe ne si komision mund të shtojmë edhe rekomandime të tjera. Ndoshta do të ishte mirë që të shtojmë edhe një pjesë ku do të thuhet për organizatat buxhetore të cilat kanë bërë shkelje ne si KMFP duhet ta kemi të qartë se çka kërkon ligji për ata që shkelin rregullat e prokurimit. Propozoi që ne si komision të kërkojmë informata shtesë për punën e komisionit si: Pasqyrë të tenderëve me procedurë të negociuar, sipas organizatave buxhetore. Pasqyrë të kontratave të nënshkruara me ofertuesit më të shtrenjtë të përgjegjshëm në rastet kur ka pasur edhe ofertues më të lirë të përgjegjshëm. Pasqyrë për numrin e tenderëve të shpallur në muajin nëntor dhe dhjetor. Ne e dimë me ligjin për buxhetin është paraparë që është e kufizuar mundësia e shpalljes së tenderëve në fund të vitit. Informatë - nëse anekskontratat e tejkalojnë 10%-shin e mundësisë mbi kontratën bazë apo janë nën 10%. Kjo si përqindje në total është 1% ,

por në raport me kontratat bazë. Këto informata komisioni nuk do t'i vlerësoi vet, por do të kërkoj nga Auditori Gjeneral një vlerësim për këto informata, pra një lloj opinionimi të kualifikuar, pastaj komisioni vlerëson nëse lind nevoja që të ftohet dikush në dëgjim publik ose jo.

**Nexhat Shabani – anëtar i bordit të KRPP-së** – Lidhur me pyetjet e anëtarëve të komisionit për efektivitetin e ligjit aktual për ndalimin abuzimeve, tha se çdo ligj nëse respektohet mirë, nuk do të ketë abuzime, mirëpo në raport me ligjet e mëhershme nuk janë eliminuar të gjitha mundësitë e keqpërdorimeve. Ne kemi dhënë disa rekomandime për plotësime dhe ndryshime të ligjit, dhe atë duke u bazuar në rekomandimet e komisionit evropian. Sa i përket kontratave Ligji për menaxhimin e financave publike si dhe ligjet e tjera caktojnë penalizim lidhur me vonesat, por kjo mbetet që autoritetet kontraktuese të këtyre kontratave ta shfrytëzojnë apo mos ta shfrytëzojnë këtë mundësi. Problemet më të mëdha në prokurim janë pas nënshkrimit të kontratave, sepse mbetet dilema nëse kontrata do të përmbushet ose jo. Kemi raste në të cilat dëmtohen edhe operatorët ekonomik sepse vonohen pagesat. Nuk ka arsye për vonesë të pagesës ndaj operatorit ekonomik nga autoriteti kontraktues, kur e marrim parasysh se Ligji për prokurim publik e thotë se asnjë procedurë e prokurimit nuk mund të iniciohet paraprakisht pa i pas mjetet e siguruar për atë aktivitet. Ligji parasheh mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit deri në momentin e nënshkrimit të kontratave nga KRPP, jo më tutje. Ai që e financon projektin ai duhet edhe ta mbikëqyrë atë, por arsyeja është që ligji nuk ka bërë një përcaktim të tillë. Ne mendojmë që me Ligj të prokurimit publik të obligohen autoritetet kontraktuese që të caktojnë komision profesional për mbikëqyrjen dhe pranimin e punës i cili do të ketë përgjegjësi për mënyrën e realizimit të punës. Sa i përket kontratave që përdoren, Ligji i prokurimit publik i njeh këto procedura dhe i përcakton rastet, mënyrën dhe arsyet se kur mund të përdoren ato. Te anekskontratat, ligji thotë 10% të vlerës së kontratës bazë, por ligji saktësisht e përcakton rastet dhe arsyet se kur mund të përdoren ato. Kur ka qenë e pamundur të përcaktohet me kontratë punët në detaje ligji e lejon mundësinë në këto raste. Kjo procedurë nuk domethënë që duhet patjetër të përdoret. Ne me këtë raport nuk kemi paraqitë kualitetin e prokurimit. Ne kemi dhënë vetëm numra, ju mund të shtroni pyetje për më shumë informata bartësve të udhëheqësve të autoriteteve se pse kanë përdorur këtë procedurë.

Sa i përket licencimit të zyrtarëve, ne konsiderojmë që çdo vit 70% kanë qenë zyrtarët e njëjtë që kanë vijuar trajnimet dhe kjo e ka kufizuar numrin e zyrtarëve që kanë mundur t'i vijnë këto trajnime. Ne kemi propozuar që pas tri certifikimeve të rregullta të njëpasnjëshme, atyre zyrtarëve tu ipet licencë e përhershme në mënyrë që tu lihet mundësia zyrtarëve të tjerë për të vijuar trajnimet. Si dhe tu mundësohet edhe zyrtarëve të prokurimit të kompanive private që të vijnë dhe të aftësohen në këto trajnime. Lidhur me ankesat gjithmonë kërkohet dy shkallshmëria. Meqenëse në OSHP shkon për herë të parë ankesa dhe ka përfunduar aty domethënë nuk ka pasur dy shkallshmëri ne konsiderojmë që mirë është që operatori teknik që konsideron që ju ka bërë e padrejtë në një procedurë të prokurimit drejtorit të kompanisë ose kryetarit të komunës t'i bëhet ankesa në mënyrë që ai të shoh pretendimet e ankuesit. Me komisionin evropian jemi në përgatitje e sipër për të bërë ndryshim të ligjit dhe kjo do të ishte reforma më radikale. Sa i përket vlerave minimale, kjo mbetet që komisioni ta vlerësoj nëse kjo shumë është e madhe, dhe mund të kërkon arsye prej autoriteteve.

Në pyetjen se procedurat e negociuara po përdoren shumë, ai u përgjigj se ne kemi paraqitur numrin e kontratave të nënshkruara përmes proceduarve të negociuara. Ligji e parasheh këtë procedurë, por parasheh edhe kriteret dhe kushtet se kur mund të përdoret kjo procedurë. Kjo procedurë përdoret në raste shumë të veçanta atëherë kur ne pas ndonjë verifikimi kemi konstatuar se nuk do të ketë konkurrencë. Por kjo paraprakisht lejohet nga Agjensioni i Prokurimit dhe nëse ky agjesion refuzon, autoriteti ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi në OSHP. Nga prokurimet që janë zhvilluar në Kosovë ka pasur mundësi që të përdoren procedurat e kufizuara, sepse për këto raste ekzistojnë konkurrenca. Ka një numër të madh të anulimeve gjatë vitit nga autoritetet kontraktuese. Kjo me arsyetimin për shkaqe objektive. Ne në dokumente standarde kemi kërkuar që të ipet sqarimi se kur mund të anulohet nga autoriteti. Mund të anulohet kur nuk kemi tri ofertat të përgjegjshme neni 30 a. 4, pra rastet objektive të përshkruhen si: mungesa e buxhetit, prioritetet kanë ndryshuar etj. Por në përgjithësi numri më i madh i

anulimeve është me arsyetimin “konkurrenca e pamjaftueshme”. Sa i përket autoriteteve kontraktuese të cilat nuk kanë dorëzuar raporte - ne përmes njoftimeve që kanë bërë këto autoritete përmes nesh, kemi konstatuar se ato autoritete kanë qenë aktive. Dhe kemi nxjerr vlerën e buxhetit që e kanë të aprovuar nga Buxheti i Kosovës. Ne jemi në kontakt me këta zyrtarë dhe gjithmonë na është premtuar se do të sjellin raportin, por kjo gjë nuk ka ndodhur dhe ne nuk kemi ndonjë mënyrë se si t'i detyrojmë për të raportuar pasi që kjo është çështje politike. Sa i përket komenteve për masat ndaj shkelësve, Ligji i prokurimit nuk parasheh masa ndëshkuese ndaj shkelësve, përveç në një rast ku thotë se mund t'i merret licenca zyrtarit të prokurimit me propozimin e autoritetit kontraktues. Ju mund të kërkoni nga KRPP për raste konkrete informata që ju interesojnë.

**Ramadan Gashi** – Tha se është shumë e madhe me marrë pjesë me 8% në modelin me tri oferta. Te rasti i anekskontratave ne jemi shteti i vetëm që kemi deri në 10%, sepse të gjitha shtetet i kanë paraparë deri në 30 e 40%. Por ne prapë jemi të mendimit që kjo përqindje të mbetet 10 pasi që vlerësojmë që te ne nuk ka vend që kjo përqindje të rritet. Kanë qenë të planifikuara të kryhen 66 monitorime në vitin e kaluar, janë kryer 51 domethënë rreth 85%. Ky është numër i vogël i planifikuar. Do të ishte mirë që të mbikëqyreshin të gjitha autoritetet kontraktuese të cilat veprojnë në Kosovë. Të njëjtin plan kem paraparë edhe për këtë vit, por dyshoj që do t'ja arrijmë deri në fund të vitit në mungesë të stafit. Sa i përket Ligjit aktual për prokurim publik, krahasuar me Ligjin 2003/17 dhe Ligjit të amendamentuar, Ligji 2003/17 ka qene ligj më i avancuar se ligji aktual.

**Riza Smaka** - Tha se i ka adresuar Qeverisë dhe Kryesisë së Kuvendit një mocion shkrimor me arsyetimin se ku duhet të ndryshohet dhe të plotësohet ligji. Kryesia e ka miratuar këtë mocion dhe e ka adresuar në Qeveri. Ofroi mbështetje si deputet për të bashkëpunuar me KRPP-në për të rishikuar ligjin dhe përmes grupi kuvendor ose përmes 6 deputetëve mund të inicohet amendimi i tij. Në këtë mënyrë do të shkonte më shpejt. Ju jeni të interesuar të keni një ligj më efikas e për të njëjtin qëllim jemi të interesuar edhe ne.

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e financave publike, njëzëri e nxori këtë*

## **PËRFUNDIM**

*Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, vlerëson se raporti me rekomandime i KRPP-së, mbi aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2009, është i plotë dhe i plotëson kushtet për tu proceduar për miratim dhe shqyrtim në seance plenare dhe **ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit të Kosovës miratimin e këtij raporti.***

*Nga shqyrtimi i raportit Komisioni vlerëson se çështje problematike- vërejtje janë: kontratat e negociuara, numri i madh i anekskontratave, anulimi i prokurimeve, tre nga autoritetet si komuna e Leposaviqit, Zveqanit dhe Zubin Potokut nuk i janë përgjigjur obligimit për t'i dërguar raportet.*

**Për nevojat e Komisionit kërkohet nga KRPP:** Pasqyrë të tenderëve me procedurë të negociuar, sipas organizatave buxhetore. Pasqyrë të kontratave të nënshkruara me ofertuesit më të shtrenjtë të përgjegjshëm( kjo të kufizohet vetëm te kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha). Pasqyrë për numrin e tenderëve të shpallur në muajin nëntor dhe dhjetor. Informatë - nëse anekskontratat e tejkalojnë 10%-shin e mundësisë mbi kontratën bazë apo janë nën 10%.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Haki Shatri**